



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Nr. Org.	Nr. Prot.
Org. Instrukc.	Prot. Instrukc.
Org. Unit.	Prot. No.
Nr. I. Fajevë	Data :
Pr. Shkruar	Datum :
No. Pjesë	Date :
Pjesë 1/1	

RAPORT I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT PËR VITIN 2017

Shkurt, 2018
Prishtinë

Raport vjetor, 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

- Baza Ligjore
- Struktura Organizative
- Drejtorati për Prokurime të Centralizuara
- Drejtorati për Prokurime të Veçanta
- Aktivitetet e përbashkëta të Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara dhe Drejtorati për Prokurime të Veçanta
- Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

BAZA LIGJORE

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është një agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave.

AQP është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të Ministrisë së Financave dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik mandatohet si organ qendror për prokurime të centralizuara qoftë në nivel qendror (Ministri) apo nivel lokal (Komuna).

AQP, konform nenit 95, pika 2 e Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Udhëzimeve Administrative, pas propozimit të Ministrit të Ministrisë së Financave dhe miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara. Kryerja e procedurave të centralizuara bëhet në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Kryerja e aktiviteteve të prokurimit për procedura të centralizuara do të bëhet në koordinim të ngushtë në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, Ministrisë së Financave dhe Autoriteteve Kontraktuese të cilat janë shfrytëzues të kontratave sipas listës së artikujve të përbashkët.

Agjencia Qendrore e Prokurimit është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës do të bëhet nga Autoritetet Kontraktuese të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata. Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin për këto kontrata do t'i paguajnë Autoritetet Kontraktuese nga kodet e tyre buxhetore.

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka kompetenca të reja si organ qendror:

AQP është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të parapara në Nenin 95 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L-042), në lidhje me zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve të prokurimeve të centralizuara dhe atyre specifike në Republikën e Kosovës, si në vijim:

- Kryen aktivitete specifike të prokurimit për dhe në emër të autoriteteve kontraktuese, të cilat do të kryhen pas një vendimi përkatës të Ministrit të Financave (MF);
- Kryen prokurime të centralizuara për artikuj të përdorimit të përbashkët, lista e të cilave do të miratohet në formë të një Udhëzimi Administrativ sipas propozimeve të MF dhe aprovimin përkatës nga qeveria;
- Kryen prokurimin për çfarëdo mallra, punë ose shërbime sipas kërkesës nga një autoritet kontraktues të aprovuar nga MF;
- Zbaton nenin 21/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin

Raport vjetor, 2017

Nr. 05/L-092 përkatësisht kryen prokurime për 16 agjenci të pavarura me më pak se 50 të punësuar të cilat i raportojnë Kuvendit të Kosovës.

- Asiston autoritetet kontraktuese me kërkesën e tyre, gjatë implementimit të aktiviteteve të prokurimit që udhëhiqen nga vetë autoritetet kontraktuese në të gjitha fazat e aktiviteteve të prokurimit.

Për më shumë, Agjencia Qendrore e Prokurimit asiston cilindo autoritet kontraktues në kryerjen e çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është duke u kryer, pas një kërkesë përkatëse nga autoriteti kontraktues në fjalë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoreti për Prokurime të Centralizuara

- Sektori për prokurime të centralizuara
- Sektori për punë dhe shërbime

Drejtoreti për Prokurime të Veçanta

- Sektori për aktivitete të prokurimit për autoritetet kontraktuese
- Sektori për prokurime nga donacionet

Drejtoreti për Buxhet dhe Shërbime të Përgjithshme

- Drejtori i Drejtoratit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Zyrtare e Lartë e Personelit;
- Përkthyes;
- Zyrtarë i Logjistikës, dhe
- Asistente

Raport vjetor, 2017

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Qëllimi dhe përfitimet

- Me prokurime të centralizuara fitohen çmime më të mira gjegjësisht kontrata më të dobishme për Autoritetet kontraktuese / Njësitë kërkuuese si shfrytëzues të atyre kontratave;
- Specifikimet për mallra dhe shërbime standardizohen dhe me këtë krijohet mundësia që shumë shfrytëzues të këtyre kontratave të përfitojnë mallra apo shërbime kualitative;
- Eliminohet në tërësi mundësia e situatave të 'konfliktit të interesit' meqë palët kontraktuese dhe implementuesit e kontratave janë krejtësisht të ndryshëm dhe ndikimi qoftë edhe i supozuar do të mungojë;
- Puna e përbashkët (në organizim të AQP-së) e shumë AK- njësive kërkuuese në hartimin e specifikave teknike dhe në procesin e vlerësimit të ofertave ngritë përgatitjen profesionale të tyre, sigurinë dhe besimin në vetë-vete dhe shkëmbimin e përvojave.
- Drejtorati i prokurimeve të centralizuara duke i publikuar të gjitha kontratat (së bashku me ofertën fituese) në web-faqen e AQP-së paraqet shembull për të gjitha AK për transparencë të plotë në raport me palët e interesuara dhe çdo qytetar tjetër.
- Procedurat e ankimimit do të jenë më funksionale sepse në vend të disa ankesave nga Operator ekonomik të pakënaqur, mund të bëhet vetëm një ankesë ndaj një propozimi të AQP-së gjë që kursen mjete financiare dhe angazhime tjera të stafit të AK.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, gjatë periudhës: 01.01.2017 deri më 31.12.2017, me sukses ka kryer aktivitetet e prokurimit, konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Udhëzimeve Administrative të aprovuara nga Qeveria e Kosovës, si ne vijim:

Tabela nr. 1. Aktivitetet e Drejtoratit për prokurime të centralizuara

Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontraktues, njoftimit	Vlera e parashikuar	Te kontraktuara	Në procedure	Lloji i kontratës	Gjendja
SHËRBIME TË PASTRIMIT LOT VII	17.01.2017	380,000.00	379,137.51		Kontrate kornize	e kontraktuar
SHËRBIME TË PASTRIMIT LOT VIII	17.01.2018	550,000.00	544,694.91		Kontrate kornize	e kontraktuar
SHËRBIME TË PASTRIMIT LOT IX	17.01.2017	1,230,000.00	1,219,814.64		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT I	04.08.2017	300,000.00	217,546.00		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT II	04.08.2017	200,000.00	152,112.25		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT III	04.08.2017	190,000.00	163,965.82		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT IV	04.08.2017	100,000.00	74,931.31		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT V	04.08.2017	130,000.00	72,202.62		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT VI	04.08.2017	190,000.00	97,731.31		Kontrate kornize	e kontraktuar
F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot I	17.11.2017	6,700,000.00	5,743,150.10		Kontrate kornize	e kontraktuar

Raport vjetor, 2017

F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot 2	17.11.2017	2,700,000.00	2,338,656.26		Kontrate kornize	e kontraktuar
F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot 3	17.11.2017	1,600,000.00	1,367,770.69		Kontrate kornize	e kontraktuar
F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot IV	11.12.2017	1,150,000.00	1,111,554.69		Kontrate kornize	
F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot V	11.12.2017			1,094,255.20	Kontrate kornize	Ne ankimim
F. ME DERIVATE TE LENGETA, Lot 6	11.12.2017			2,459,164.30	Kontrate kornize	Ne ankimim
MARRJA E VETURAVE ME QIRA 1/1, KAT. 1	24.10.2017	1,615,000.00	1,271,556.00		Kontrate afatgjate	e kontraktuar
MARRJA E VETURAVE ME QIRA, 1/2, KAT.1	24.10.2017	1,615,000.00	1,238,952.00		Kontrate afatgjate	e kontraktuar
MARRJA E VETURAVE ME QIRA, 2/1, KAT.2	16.10.2017	2,350,000.00	2,336,004.00		Kontrate afatgjate	e kontraktuar
MARRJA E VETURAVE ME QIRA, 2/2, KAT.2	16.10.2017	2,350,000.00	2,336,004.00		Kontrate afatgjate	e kontraktuar
MARRJA E VETURAVE ME QIRA, 3/1, KAT 3.	29.12.2017	1,287,000.00	1,281,749.04		Kontrate afatgjate	e kontraktuar
MARRJA E VETURAVE ME QIRA, 3/1, KAT 3.	29.12.2017			1,281,749.04	Kontrate afatgjate	ne ankimim
FURNIZIMI ME MAZUT	03.11.2017	630,000.00	567,131.66		Kontrate kornize	e kontraktuar
FURNIZIMI ME PAISJE TI	06.12.2017	N/A		6,000,000.00	Marrëveshje kornize	Njoftim për kontrate

Raport vjetor, 2017

SHERBIME TE FOTOKOJIMIT DHE PRINTIMIT	26.12.2017	N/A		8,500,000.00	Kontrate afatgjate	njoftim për kontrate
FURNIZIM ME MALLRA PER ZYRE	27.12.2017	N/A		610,000.00	Kontrate kornize	njoftim për kontrate
Gjithsej		25,267,000.00	22,514,664.81	19,945,168.00		

Tabela nr. 1

Nga te dhënat e paraqitura ne tabelën nr. 1 shihet se vlera e parashikuar e kontratave nga Autoritetet Kontraktuese qe kane bere kërkesa ne Agjencinë Qendrore te Prokurimit për zhvillimin e aktiviteteteve te prokurimit është 25,267,000.00 € ndërsa vlera e mallrave dhe shërbimeve sipas vlerës se kontratave është 22,514,664.81 €. Është arritur qe gjate zhvillimit te aktiviteteteve te prokurimit te kursehen mjete ne vlere prej 2,752,335.19 €. Shprehur ne përqindje norma e kursimeve është 12.22 %.


Shënim: Ne këtë analizë janë te përfshira vetëm kontratat e nënshkuara.

Këto rezultate te kursimeve te mjeteve buxhetore janë arritur fale transparencës dhe punës profesionale qe kane treguar zyrtaret e Agjencisë Qendrore te Prokurimit gjate zhvillimit te aktiviteteteve te prokurimit.


Grafiku nr. 1.

Paraqitja grafike e aktiviteteteve të prokurimit sipas llojit të kontratës:

- Kontrata për furnizime ;
- Kontrata qiramarrje dhe
- Kontrata për shërbime



Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike e kontratave në Drejtoratin e Prokurimeve të Centralizuara për vitin 2017, vlera e parashikuar, vlera e kontraktuar dhe kursimi



Raport vjetor, 2017


Drejtoria për Prokurimeve të Veçanta

Drejtoria për Prokurimeve të Veçanta gjate periudhës: **01.01.2017** deri **31.12.2017** me sukses ka kryer aktivitetet dhe përgjegjësit me të cilat është i ngarkuar. Konform nenit 95, paragrafi 4 dhe nenit 21/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 kemi zhvilluar gjithsej **74** aktivitete të prokurimit. Ne mungese të ofertave të përgjegjshme janë anuluar **21** aktivitete të prokurimit. Janë ri-tenderuar **13** aktivitete të prokurimit ndërsa me kërkesën e Agjencive të Pavarura pas anulimit për **8** aktivitete të prokurimit nuk është vazhduar me ri-tenderim. **13** aktivitete të prokurimit kanë qene te ndare ne me shume se një pjese (lot). Gjate vitit 2017 gjithsej janë nënshkruar **83** kontrata me Operatoret Ekonomik. Krahasuar me vitin paraprak 2016 ku janë zhvilluar vetëm **41** aktivitete të prokurimit ne vitin 2017 kemi pasur një rritje te numrit te aktiviteteve te prokurimit për **80.50 %**.

Tabela nr.2

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROKURIMIT						
N r.	Lloji i Prokurimit	Vlera e kontratave		Pjesëmarrja në %		Krahasimi i totalit te vlerave mes viteve 2017/2016
		2016	2017	2016	2017	
1	Furnizime	206,034.27	343,125.87	50.40	26.76	
2	Shërbime	202,745.67	937,768.35	49.60	73.13	
3	Punë	0.00	1,440.07	0.00	0.11	
Gjithsej		408,779.95	1,282,334.29	100.00	100.00	213.70%

GRAFIKU 3: VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROKURIMIT




Raport vjetor, 2017

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 1 dhe grafikun 1, krahasuar me vitin paraprak 2016, shihet së totali i vlerës së kontratave të nënshkruar është rrite për 213.70 %

TABELA 3: VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT					
Nr.	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave		Pjesëmarrja në %	
		2016	2017	2016	2017
1	Procedurë e hapur	339,822.84	1,133,443.11	83.13	88.39
2	Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	2,440.00	84,120.80	0.60	6.56
3	Procedurë e kuotimit të çmimeve	58,209.97	41,988.53	14.24	3.27
4	Procedurë e vlerës minimale	8,307.14	22,781.85	2.03	1.78
Gjithsej		408,779.95	1,282,334.29	100.00	100.00

GRAFIKU 4: VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT



Raport vjetor, 2017

TABELA 4: LISTA E AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT QË KANË PËRFUNDUAR ME NËNËSHKRIM KONTRATË				
Nr.	Numri i prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar ne €	Vlera e kontraktuar ne €
1	AQP-AK-17-03- 235	Visual Studio Premium with MSDN Subscription Renewal	2,500.00	2,500.00
2	AQP-AK-17-05-221	Shërbimet e sigurimit fiduciar për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	25,833.00	22,511.00
3	AQP-AK-17-07-236	Mirëmbajta dhe instalimi i pajisjeve të Mikrosoftit si dhe ripërtëritja e domainit dhe hostingut të web faqes të Zyrës së Rregullatorit për Energji	5,000.00	4,820.00
4	AQP-AK-17-10-221	Shërbimet e përkthimit dhe lekturimit për nevojat e Agjencive të pavarura	119,709.00	112,842.29
5	AQP-AK-17-11-236	Shërbime të shtypjes së Raportit vjetor	9,777.50	2,695.80
6	AQP-AK-17-13-136	Furnizim me aparate telefonike-mobil për nevojat e agjencive të pavarura- Pjesa 2- Furnizim me aparate telefonike- mobil për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media	1,920.00	1,760.00
7	AQP-AK-17-15-111	Furnizim me pajisje të teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 8	8,000.00	5,470.00
8	AQP-AK-17-15-111	Furnizim me pajisje të teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 17	€ 3,000.00	2,998.79
9	AQP-AK-17-15-111	Furnizim me pajisje të teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 18	€ 13,000.00	9,740.77
10	AQP-AK-17-15-111 Ri-tender	Furnizim me pajisje të teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 1, Pjesa 6, Pjesa 7, Pjesa 9	18,750.00	16,105.00
11	AQP-AK-17-15-111 Ri-tender	Furnizim me pajisje të teknologjisë informativë për	6,580.00	6,481.00

Raport vjetor, 2017

		nevojat e Agjencive te Pavarura- Pjesa 2, Pjesa 13		
12	AQP-AK-17-15-111 Ri-tender	Furnizim me pajisje te teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive te Pavarura- Pjesa 5	24,900.00	
13	AQP-AK-17-15-111 Ri-tender	Furnizim me pajisje te teknologjisë informativë për nevojat e Agjencive te Pavarura- Pjesa 8, Pjesa 11	7,685.00	7,240.00
14	AQP-AK-17-16-247	Servisimi i rregullt i automjeteve te ARKEP-it	950.00	937.00
15	AQP-AK-17-17-147	Furnizim me dhurata (suvenire) për delegacione te ndryshme për nevojat e Komisionit Rregullativ te Prokurimit Publik	950.00	871.00
16	AQP-AK-17-018-221	Shërbimet e pastrimit dhe mirmbajtjes se objekteve te Agjencive te Pavarura	82,792.00	57,223.34
17	AQP-AK-17-019-236	Shërbime të transportit rrugorë në relacionin Prishtinë – Lubjanë dhe anasjelltas, për nevojat e zyrtareve të Agjencisë për Ndihme Juridike Falas	1,500.00	1,340.00
18	AQP-AK-17-020-136	Furnizim me ormana metalik për nevojat e Agjencive te Pavarura - Pjesa 1	3,000.00	2,266.00
19	AQP-AK-17-020-136	Furnizim me ormana metalik për nevojat e Agjencive te Pavarura - Pjesa 2	1,800.00	1,320.00
20	AQP-AK-17-021-211	Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 10	6,000.00	6,000.00
21	AQP-AK-17-021-211	Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 11	12,000.00	12,000.00
22	AQP-AK-17-021-211 Ri-tender	Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 1, 6,13	36,900.00	36,900.00
23	AQP-AK-17-021-211 Ri-tender	Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa - 2,3,4,5,7,8,9,10,11,12,14	139,040.00	139,040.00

Raport vjetor, 2017

24	AQP-AK-17-023-236	Shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes në objektet e Akademisë së Drejtësisë	1,950.00	1,444.66
25	AQP-AK-17-026-121	Furnizim me toner për nevojat e Agjencive të pavarura	22,460.00	15,889.16
26	AQP-AK-17-027-221	Shërbime të akomodimit, ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit në trajnime sipas nevojave të Akademisë së Drejtësisë- Pjesa 3:	23,000.00	24,998.00
27	AQP-AK-17-031-221	Shërbime të sigurimit për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 1	6,365.16	6,190.00
28	AQP-AK-17-032-247	Vazhdimi i hostingut të webfaqes së ww.kosix.net	215.46	215.46
29	AQP-AK-17-033-221	Auditimi i jashtëm i Pasqyrave Financiare për nevojat e Fondit për Kursime Pensionale të Kosovës	45,000.00	26,550.00
30	AQP-AK-17-034-221 Ri-tender	Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura	22,070.00	11,398.00
31	AQP-AK-17-038-221 Ri-tender	Servisimi dhe mirëmbajtja e klimave për nevojat e agjencive të pavarura	14,850.00	14,850.00
32	AQP-AK-17-043-121	Furnizim me veture për nevojat e Këshillit Prokurorial të Kosovës	66,000.00	58,507.00
33	AQP-AK-17-044-236	Shërbimet e Sigurimit Fizik të Objektivit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit	9,990.00	6,482.40
34	AQP-AK-17-045-121	Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnit për nevojat e Agjencive të Pavarura	26,047.20	13,518.30
35	AQP-AK-17-046-136	Furnizimi dhe montimi i klimave për nevojat e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	2,000.00	1,963.52
36	AQP-AK-17-047-211	Mirëmbajtja e Pajisjeve të Monitorimit – për Komisionin e Pavarur të Mediave	218,362.96	218,361.80
37	AQP-AK-17-049-221	Krijimi, dizajni dhe mirëmbajtja e uebfaqeve për nevojat e agjencive të pavarura- Pjesa 1,2,3,4,5,6	17,785.00	9,340.00

Raport vjetor, 2017

38	AQP-AK-17-049-221	Krijimi, dizajnimi dhe mirëmbajtja e ueb faqeve për nevojat e agjencive te pavarura- Pjesa 7	6,000.00	2,800.00
39	AQP-AK-17-050-221	Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT-së për nevojat e Agjencive te pavarura, Pjesa 1,2,3,4,5,6,7,8,11,12,13,14,15	62,531.00	62,531.00
40	AQP-AK-17-054-211	Shtypja dhe zarfimi i pasqyrave individuale dhe njoftimeve tjera dhe shtypja e formularëve	180,000.00	51,000.00
41	AQP-AK-17-056-225	Mirëmbajtja e platformës së Prokurimit Publik për periudhën tetor 2017 deri shkurt 2018	70,000.00	70,000.00
42	AQP-AK-17-059-136	Furnizim me mobile për nevojat e Agjencisë Kundër Korrupsionit	4,908.80	2,530.00
43	AQP-AK-17-062-221	Sigurimi Shëndetësor për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	13,000.00	8,700.00
44	AQP-AK-17-063-121	Furnizim me pajisje të IT për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 1	24,500.00	24,363.94
45	AQP-AK-17-063-121	Furnizim me pajisje të IT për nevojat e Agjencive të Pavarura- Pjesa 2 dhe Pjesa 3	7,455.00	6,275.60
46	AQP-AK-17-064-236	Shërbimet për mirëmbajtjen e platformës së kualitetit të shërbimeve (QoS) të zërit dhe SMS	7,500.00	€ 7,476.00
47	AQP-AK-17-066-136	Furnizim me UPS dhe pajisje tjera të IT për nevojat e tri Agjencive të Pavarura -Pjesa 2	2,160.00	2,141.28
48	AQP-AK-17-067-136	Furnizim me aparate telefonike-mobil për nevojat e bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.	3,000.00	1,360.00
49	AQP-AK-17-068-121	Furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	122,220.00	102,360.00
50	AQP-AK-17-069-136	Furnizim me mobile për nevojat e Agjencive të Pavarura , Pjesa 1 dhe Pjesa 3	6,000.00	4,085.00


Raport vjetor, 2017

51	AQP-AK-17-069-136	Furnizim me mobile për nevojat e Agjencie të Pavarura - pjesa 2	2,734.00	2,684.00
52	AQP-AK-17-070-121	Furnizim me Licenca të Microsoft-it për nevojat e Zyrës së Rregullatorit për Energji	12,000.00	8,645.12
53	AQP-AK-17-073-136	Furnizim me letër higjienike dhe tualetit	4,157.00	3,540.00
54	AQP-AK-17-074-121	Furnizim me uij për nevojat e Agjencie te Pavarura	12,486.50	8,315.00
55	AQP-AK-17-076-225	Emetimi i video reklamave: Pjesa 1- RTK1	12,000.00	3,404.80
56	AQP-AK-17-076-225	Emetimi i video reklamave: Pjesa 2- RTV21	9,000.00	3,648.00
57	AQP-AK-17-076-225	Emetimi i video reklamave: Pjesa 3- KTV	9,000.00	3,648.00
	27 aktivitete me vlerë minimale		20,961.00	17,168.00
Totali 01.01.2017 deri 31.12.2017			1,599,751.08	1,282,334.29
Totali i vlerës së mjeteve të kursyera				317,416.79

TABELA 5: VLERA E KONTRATAVE TË NËNËSHKRUARA SIPAS VITEVE					
Nr.	Lloji i Prokurimit	Vlera e kontratave		Vlera e kursimeve ne % viti 2016	Vlera e kursimeve ne % viti 2017
		2016	2017		
1	Vlera e Parashikuar	596,045.40	1,599,751.08		
2	Vlera e Kontraktuar	408,779.95	1,282,334.29		
3	Vlera e kursimeve	187,265.45	317,416.79	45.81	24.75

GRAFIKU 5: VLERA E PARASHIKUAR, VLERA E KONTRATAVE DHE VLERA E KURSIMEVE 2016,2017

Raport vjetor, 2017



Nga të dhënat e paraqitura në tabelën Nr. 3 dhe grafikun nr. 3 shihet se vlera e parashikuar e aktiviteteve të prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese që kanë bërë kërkesa në Agjencinë Qendrore të Prokurimit për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2017 është **1,599,751.08 €**, ndërsa vlera kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017 është **1,282,334.29 €**. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit në vitin 2017 është arritur që të kursehen mjete buxhetore në vlerë prej **317,416.79 €**, apo shprehur në përqindje **24.75 %**.

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, punës profesionale që kanë treguar zyrtarët e Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta dhe bashkëpunimit të mirëfillt me zyrtarët e Autoriteteve Kontraktuese për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.

Gjatë periudhës raportuese 1 janar 31 dhjetor 2017 janë anuluar gjithsej 21 aktivitete të prokurimit, kryesisht për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Aktivitete tjera të zyrtarëve të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta

- Në fillim të çdo muajit, kemi bërë kalkulimin e çmimeve të karburanteve për muajin paraprak, konform kushteve të kontratës nr. 7/2014 të datës 15.09.2014 me numër të prokurimit: AQP-AK-14-002-111,
- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkruara për vitin fiskal 2016 (formën standarde të KRPP-se);
- Kemi hartuar raportin vjetor të punëve dhe aktiviteteve të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta për vitin fiskal 2016 dhe të njëjtin e kemi dërguar të Drejtori Ekzekutiv i AQP-se;
- Konform nenit 95. paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi dhënë mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktiviteteve të prokurimit.
- Të punësuarit në Drejtoratin e Prokurimeve të Veçanta sipas kërkesave të zyrtareve përgjegjës të AQP-se, kanë marrë pjesë në seminare, punëtori, grupe punues dhe trajnime të organizuara nga institucione vendore dhe ndërkombëtare

Raport vjetor, 2017

➤ **Përveç rezultateve të arritura, Drejtoria e Prokurimeve të Veçanta gjatë realizimit të objektivave për vitin 2017 është ballafaquar edhe me disa probleme dhe vështirësi, ku me të theksuarat kanë qene:**

- Numri i vogël i zyrtareve të prokurimit, kur dihet se me ndryshimet e LPP, këtij Drejtoria i janë shtuar përgjegjësit për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit për 16 Agjenci të Pavarura (neni 21A) dhe Kërkesat që vijnë nga Autoritetet Kontraktuese e të cilat aprovohen nga Ministri i Ministrisë së Financave (neni 95 paragrafi 4).
- Mos harmonizimi i planeve të prokurimit të Agjencive të Pavarura, ku shpesh herë jemi obliguar që të zhvillojmë disa aktivitete të prokurimit për mallra apo shërbime të njëjta , por në periudha të ndryshme kohore;
- Hartimi jo profesional i specifikave teknike nga Autoritetet Kontraktuese;
- Propozimet nga Autoritetet Kontraktuese të anëtareve për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të ofertave pa përgatitje adekuate profesionale me natyrën e furnizimeve, shërbimeve, etj, për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit;

➤ **Për të mos u ballafaquar me probleme të njëjta në vitet e ardhshme rekomandoj që menaxhmenti i Agjencisë Qendrore të Prokurimit të ndërmerr këto veprime:**

- Plotësimi i pozitave të zbrazëta të punës dhe rritja e numrit të zyrtareve të prokurimit në Drejtoratin e Prokurimeve të Veçanta;
- Të shikohet mundësia e rritjes së pagave apo forma tjera të stimulimit material të Zyrtareve të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta;
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i punëtorëve në të cilat do të marrin pjesë Zyrtaret Përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe Zyrtaret Përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit;
- Të kërkohej nga Autoritetet Kontraktuese që dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në AQP që specifikat teknike të hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP dhe në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri profesionale lidhur me mallrat, shërbimet, punët, etj, që janë duke u zhvilluar aktivitetet e prokurimit
- Dërgimi i stafit të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta në seminare dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit që ligjërohen tema nga zhvillimi i praktikave me të mira të prokurimit publik;

Aktivitetet e përbashkëta të Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara dhe Drejtoratit për Prokurime të Veçanta

Raport vjetor, 2017

Paraqitja e aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2017 për Drejtoratin e prokurimeve të centralizuara dhe Drejtoratin e prokurimeve të veçanta:

Tabela 6.

Nr.	Drejtoratet	Vlera e parashikuar ne €	Vlera e kontraktuar ne €	Vlera e Kursimeve ne €	Kursimet ne %
1	Prokurime të centralizuara	25,267,000.00	22,514,664.81	2,752,335.19	12.89 %
2	Prokurime të veçanta	1,599,751.08	1,282,334.29	317,416.79	
	Gjithsej	26,866,751.00	23,796,998.00	3,069,751.00	

Pra, në total gjatë viti 2017 AQP-ja ka kontraktuar 23,796,998.00 € dhe ka arritë të kursejë 3,069,751.00€.

Përveç rezultateve të arritura, Agjensia Qendrore e Prokurimit gjatë realizimit të objektivave për vitin 2017 është ballafaquar edhe me disa probleme dhe vështirësi ku me të theksuarat kanë qene: Numri i vogël i zyrtareve të prokurimit, kur dihet se me ndryshimet e LPP, AQP-së i janë shtuar përgjegjësitë për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit për 16 Agjenci të Pavarura (neni 21A) dhe Kërkesat që vijnë nga Autoritetet Kontraktuese e të cilat aprovohen nga Ministri i Ministrisë së Financave (neni 95 paragrafi 4).

Ka pasur vonesa deri në fillimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit për AQP në lidhje me E-prokurimit, sepse fillimisht AQP ka qenë e obliguar që të zhvillojë procedurat vetëm përmes E-prokurimit por, Qeveria e Kosovës përkatësisht KRPP-ja ja mundëson AQP-së që ofertat të pranojë edhe formën fizike edhe elektronike.


Hartimi jo profesional i Specifikave teknike nga Autoritetet Kontraktuese- të cilat kanë dorëzuar kërkesat në AQP për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit e që ka ndikuar që në të shumtën e rasteve të shpenzohet shumë kohë për ri-hartimin e dhe rregullimin e tyre dhe kërkesa e shumë institucioneve që të janë pjesë e prokurimeve qendrore pas përfundimeve të aktiviteteve të prokurimit.

Propozimet nga Autoritetet Kontraktuese të anëtareve për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të ofertave pa përgatitje adekuate profesionale me natyrën e furnizimeve, shërbimeve, etj, për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.

Grafiku i vlerave të përlogaritura, vlerave të kontraktuara dhe kursimi i siguruar në dobi të buxhetit të Kosovës.

Grafiku 6.

Raport vjetor, 2017



Kërkesat për vitin 2018 për përmbushjen e planeve dhe obligimeve:

- Rritja e numrit të zyrtareve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit,
- Shtimi i fondeve për trajnime dhe për mbulimin e shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve në hartimin e termave të referencës
- Angazhimi i zyrtarëve në punë jashtë orarit dhe angazhime ditëve të vikendit në vllugun e punëve
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i një punëtorie në të cilin do të marrin pjesë Zyrtaret Përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe Zyrtaret Përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit për vitin fiskal 2018.
- Organizimi i dy punësorive, një me zyrtarë të nivelit qendror dhe tjetra me zyrtarë të nivelit lokal për harmonizimin e kërkesave dhe qëllimeve dhe për uniformimin e dokumenteve për paraqitjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike.
- Të kërkohej disiplinë dhe përgjegjësi e njësisë kërkuese përkatësisht e Autoriteteve kontraktuese në ofrimin e shënimeve dhe specifikimeve teknike për aktivitetet e prokurimit që duhet të zhvillojë AQP-ja.

Raport vjetor, 2017

- Te kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese qe dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve te prokurimit ne AQP qe specifikat teknike ti hartojnë ne mënyre profesionale dhe ne harmoni me depozitat e LPP.
- Te kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese për te cilat zhvillohen aktivitetet e prokurimit qe për pjesëmarrje ne komisione te vlerësimit te ofertave te propozojnë anëtare qe kane njohuri lidhur me mallrat, shërbimet, punët, etj, qe janë duke u zhvilluar aktiviteti i prokurimit.
- Dërgimi i Zyrtareve te prokurimit ne seminare dhe trajnime ne vende dhe jashtë vendit qe ligjërohen tema nga zhvillimi i aktiviteteve te prokurimit sipas Rregulloreve dhe legjislacionit te Bankës Botërore
- Të bëhen trajnime shtesë për e-prokurim.

Arsyetim

Përkrahja institucionale, financiare dhe kadrovike e AQP-së do të rezultojnë me kursime milionëshe, me kursim të kohës dhe mjeteve për AK.

Po ashtu janë të pritshme edhe përzgjedhje të kompanive serioze me ç 'rast pritjet të sigurohet furnizime dhe shërbime më cilësore.

AQP gjatë punës së vet do të angazhojë edhe zyrtarë nga AK të nivelit lokal dhe qendror të cilët mund të fitojnë përvoja në punë ekipore në vlerësimin e projekteve me vlera të mëdha.

Një AQP e përkrahur do të jetë një storie suksesi për Ministrinë e Financave dhe për AK duke siguruar kontrata të dobishme dhe duke përmbushur arsyen e ekzistimit të saj.

Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për vitin 2017, përfshinë aktivitetet e kryera sipas kushteve të kontratës dhe përgjegjësi shtesë për :

- Përkthyesen e gjuhës angleze,
- Përkthyesen e gjuhës serbe dhe
- Zyrtarja e Lartë e Personelit.

Shpenzimet buxhetore gjatë vitit fiskal 2017

Shpenzimet që janë kryer gjatë vitit fiskal 2017, gjithsejtë nëntëdhjetë (90) lëndë, nga kategori të ndryshme ekonomike, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Raport vjetor, 2017

Tabela 7.

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje	Kodi ekonomik	Shuma
Shpenzime të telefonisë mobile	- 13320	3,760.00
Karburante për vetura	- 13780	2,551.08
Drekë Zyrtare	- 14310	2,671.50
Mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve	- 14010	105.90
Mëditje – Udh. Zyrtare Jashtë Vendl	- 13141	1,063.32
Mobilje më pak se 1000	- 13501	982.00
Shpenzime të udhëtimit jashtë vendl	- 13140	77.60
Akomodim Udh. Zyrtarë Jashtë vendl	- 13142	111.00
Shërbime tjera kontraktuese	- 13460	24,603.32
Kompjuter më pak se 1000	- 13503	2,793.57
Reklamat dhe konkurset	- 14210	60.00
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	- 13410	2,100.00
Furnizim për zyre	- 13610	1,918.80
Konunali/telefoni fikse	- 13250	792.07
Totali		43,590.16
Paga dhe mëditje – Janar-shkurt 2017		87,148.60
Totali		130,738.76

Raport vjetor, 2017

Përkthyesja e gjuhës angleze dhe zyrtare e shpenzimeve

Përkthyesja e gjuhës angleze, gjatë vitit 2017 ka kryer përkthime të materialeve dhe aktivitetet si në vijim:

- Dosje të tenderit, gjithsejtë njëzetekatër (24), Njoftim për nënshkrim të kontratës, gjithsejtë tri (3), Njoftime për anulim të aktivisteve të prokurimit, gjithsejtë tetë (8), Përkthim i vendimeve, gjithsejtë pesë (5), Përkthim i korrespondencave me institucionet ndërkombëtare, Banka Botërore, SIGMA, përkthim i materialeve lidhur me Integrimet Evropiane dhe MSA (fusha e prokurimit) dhe përkthime tjera sipas kërkesave të drejtorit dhe zyrtarëve tjerë.
- Aktivitetet e kryera gjatë kësaj periudhe kohore si zyrtare shpenzuese:
- Aktivitetet e kryera lidhur me buxhet dhe prokurim.

Përkthyesja e gjuhës serbe dhe zyrtare e zotimeve

Përkthyesja e gjuhës serbe, gjatë vitit 2017 ka kryer përkthime të materialeve dhe aktivitetet si në vijim:

- Dosje të tenderit: 37, Kuotim i çmimeve:16, Njoftime për kontratë:20, Njoftime për dhënie të kontratës:16, Njoftime për nënshkrim të kontratës:29, Njoftime për anulimin e aktivitetit të prokurimit:5, Informata për Operatorët Ekonomik:17, Specifikacione teknike të aktiviteteve të prokurimit:3 si dhe ka marrë pjesë në hapje të tenderëve për nevojat e dy drejtorateve:
- Zotimi i mjeteve:

Zyrtarja e Larte e Personelit dhe certifikuese

- Evidentimi i ardhje- vajtje ne pune nga janari deri ne dhjetor, Listat e Pagave evidentimi i tyre për muajin janar deri në dhjetor 2017. ,Njoftimi ne MAP rreth Planit te Personelit me atë te MF.
- Njoftimi (Planit te Punës) për stafin e AQP-së, plani i trajnimeve për nëpunësit e AQP ne MAP dhe realizimi i tyre ne 2017, plani i pushimeve dhe realizimi i tyre për 2017, planifikimi i Rekrutimi ne AQP me date:30.06.2017, Vendime tjera lidhur me pushimet vjetore, pushimet e lehonisë rekrutimin etj.
- Aprovimi i lendeve të shpenzuara në SIMFK.